



ANALIZË LIGJORE

**MBI FINANCIMIN E OJQ-VE
QË PËRFITOJNË NGA FONDET E BE-së
(BASHKËFINANCIMI)**



Autor: Enis SPAHIU

Dizajni grafik: Fleta Baraku

OPEN SOCIETY
FOUNDATIONS
WESTERN BALKANS

*Ky dokument u mundësua me mbështetjen e Open Society Foundations - Western Balkans.
Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetme e Platforma CiviKos dhe nuk pasqyron
domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit.*



ANALIZË LIGJORE

MBI FINANCIMIN E OJQ-VE QË PËRFITOJNË NGA FONDET E BE-së (BASHKËFINANCIMI)

Nëntor 2025

PËRMBAJTJA

5	HYRJE
6	1. INFRASTRUKTURA AKTUALE LIGJORE LIDHUR ME BASHKËFINANCIMIN
8	2. DISA PERSPEKTIVA NGA SHTETET E RAJONIT
9	2.1 Shqipëria
10	2.2 Mali i Zi
12	2.3 Kroacia
14	2.4 Maqedoni e Veriut
15	3. DISA OPSIONE PËR POLITIKËBËRËSIN
16	3.1 Opsion i Status Quo-s
18	3.2 Opsioni i Ligjit Vjetor për Ndarjet Buxhetore
20	3.3 Opsioni i një akti nënligjor të veçantë
22	3.4 Opsioni i ndryshimeve ligjore
23	3.5 Krahassimi i opsioneve
24	4. SIGURIMI I BASHKËFINANCIMIT NGA NIVELI KOMUNAL
26	5. PËRFUNDIMI

HYRJE

Republika e Kosovës ka orientim të qartë strategjik për integrimin në Bashkimin Evropian (BE) dhe kjo është reflektuar edhe në preambulën e *Kushtetutës së Republikës së Kosovës*, ku nënvizohet synimi i qartë për përfshirje në procese integruese. Për më tepër, Republika e Kosovës ka krijuar marrëdhënie kontraktuale me BE-në, efektive nga data 1 prill 2016, ku parashihen një sërë reformash dhe ndryshimesh strukturore, me qëllim të përafrimit me standardet BE-së. Ndër tjerash, kjo marrëveshje njeh angazhimin e palëve në zhvillimin e shoqërisë civile, si një element thelbësor për demokracinë dhe avancimin e procesit të integritimit evropian. Konkretisht, MSA-ja parasheh që të nxitet pjesëmarrja aktive e shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe mbikëqyrjen e reformave, përfshirë edhe zbatimin e MSA-së, të mbështetet zhvillim i një shoqërie civile të fortë dhe të pavarur dhe të krijohen kushte të favorshme ligjore dhe administrative për shoqërinë civile. Në anën tjetër, në komponentin financiar parashihet mbështetja financiare për organizatat joqeveritare (OJQ) që punojnë në promovimin e standardeve evropiane dhe ndërmarrjen e iniciativave për rritjen e kapaciteteve të OJQ-ve për të marrë pjesë në projektet financiare nga fondet e BE-së.

Nga perspektiva e obligimeve karshi sektorit të shoqërisë civile që burojnë nga MSA-ja, Republika e Kosovës ka arritur një progres relativisht të moderuar, pasi është rishikuar infrastruktura ligjore që rregullon shoqërinë civile, është krijuar një standard unik për financim publik të OJQ-ve, janë krijuar disa lehtësira procedurale dhe tatimore për aktivitetet e shoqërisë civile si dhe është krijuar infrastruktura ligjore për ndërmarrësinë sociale. Megjithatë, disa sfida dhe ngecje janë evidente në këtë fushë, ku njëra prej tyre është edhe çështja e bashkëfinancimit të organizatave të shoqërisë civile, për mbulimin e pjesës së pambuluar nga fondet e programeve të BE-së. Kjo paraqet një sfidë shumë të rëndë për OJQ-të Kosovë, për shkak të burimeve të kufizuara dhe paqëndrueshmërisë financiare, e sidomos për OJQ-të që veprojnë në nivel lokal.

Kjo analizë ka për synim ofrimin e disa opsioneve për hartuesin e politikave për mënyrën e sigurimit të infrastrukturës ligjore të bashkëfinancimit të projekteve OJQ-ve, që qasja e tyre në fondet e BE-së të jetë më e përballeshme për ata.

1. INFRASTRUKTURA AKTUALE LIGJORE LIDHUR ME BASHKËFINANCIMIN

Infrastruktura ligjore lidhur me financat publike, nga e cila do të derivojë apo duhet të derivojë edhe rregullimi ligjor i çështjes së bashkëfinancimit të projekteve të OJQ-ve që përfitojnë nga fondet e BE-së, rregullohet me *Ligjin Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë*, i plotësuar dhe ndryshuar (LMFPP), me aktet nënligjore që rrjedhin nga ky ligj, si dhe disa ligje të tjera që adresojnë komponentët e veçantë të menaxhimit të financave publike. Nga perspektiva e shpenzimit të parasë publike, çdo lloj financimi i OJQ-ve që nuk synon marrjen e ndonjë shërbimi nga ato, trajtohet në kuadër të kategorisë së shpenzimeve “subvencione dhe transfere”. Lidhur me këtë, referuar nenit 53 të LMFPP-së, realizimi i shpenzimeve nga kjo kategori është subjekt i disa kufizimeve, si në vijim:

- Asnjë organizatë buxhetore/institucion nuk mund të japë një financim të tillë nëse nuk ka të ndarë paraprakisht mjetet e nevojshme buxhetore;
- Asnjë organizatë buxhetore nuk mund të japë një financim të tillë përtej masës së lejuar shprehimisht nga ndarja buxhetore; dhe
- Çdo financim i tillë duhet të jetë në përputhje me rregullat e tjera buxhetore si dhe me rregullat e nxjerra nga Ministri përkatës i financave.

Lidhur me rregullat e veçanta të nxjerra nga Ministria përkatëse për financa, kjo ministri ka të aprovuar *Rregullin Financiar 01/2013/MF – Shpenzimi i Parasë Publike* (Rregullore për Shpenzimin e Parasë Publike), ku në nenin 36 kërkohet që për çdo shpenzim nga subvencionet dhe transferet të ketë bazë të qartë juridike, pra duhet të bazohet në një ligj, rregullore ose vendim të institucioneve përkatëse që i mundëson organizatës buxhetore ta bëjë një pagesë nga kjo kategori. Ndërsa, në kontekst të financimit të OJQ-ve dhe si rregullore e veçantë është nxjerrë *Rregullorja MF - Nr.04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të Organizatave të Shoqërisë Civile* (Rregullore për Financimin Publik të OJQ-ve), e cila ka për qëllim rregullimin uniform të kriterëve dhe procedurave të financimit të OJQ-ve për të gjitha organizatat buxhetore në Republikën e Kosovës.

Rregullorja për Financim Publik të OJQ-ve ka për synim të sigurojë një formë të drejtë dhe të barabartë, në mënyrë efikase dhe transparente të financimit publik të OJQ-ve nga fondet publike për realizimin e interesit publik. Në veçanti, ky akt nënligjor përcakton parimet e financimit publik, procedurat e thirrjeve publike, kriteret e përzgjedhjes së OJQ-ve dhe mënyrën e vlerësimit të projekteve, detyrimin e përfituesve për raportim, monitorimin e

marrëveshjeve si dhe masat administrative në rast të mospërbushjes së obligimit nga përfituesit.

Në analizat lidhur me Rregulloren për Financimin Publik të OJQ-ve, vërehet se ky akt nënligjor nuk ka ndonjë rregullim të veçantë për lidhur me bashkëfinancimin e projekteve të OJQ-ve, e as që synimi i hartuesit ka qenë adresimi edhe i kësaj çështjeje me këtë akt nënligjor. Megjithatë, në kuadër të rregullimit të kriterëve specifike të shpalljes publike për financim të OJQ-ve, ka paraparë një specifike për bashkëfinancim, sipas së

cilës OJQ-të duhet të sigurojnë dëshmitë e duhura për projektet për të cilat kërkohet bashkëfinancim, nëse është i aplikueshëm.

Në anën tjetër, nuk ka ndonjë pengesë në dispozitat e Rregullores për Financimin Publik të OJQ-ve që bashkëfinancimi i projekteve të OJQ-ve të realizohet sipas këtij akti nënligjor. Sidoqoftë, ky opsion kërkon që institucionet të kenë kapacitetet të mjaftueshme për zbatimin e Rregullores për Financimin Publik të OJQ-ve dhe disa praktika të zbatimit të saj të përshtaten për bashkëfinancimin e projekteve të OJQ-ve.

2. DISA PERSPEKTIVA NGA SHTETET E RAJONIT

BE-ja ka programe të veçanta që synojnë zbatimin e politikave të veçanta të BE-së dhe forcimin e bashkëpunimit në mes të shteteve anëtare, apo në mes të shteteve anëtare dhe shteteve që janë në fazën e para-anëtarësimit. Realisht, këto programe shumëvjeçare fillimisht kanë qenë të hapura dhe të orientuara vetëm për shtetet anëtare të BE-së. Por, nga viti 2003 ato u hapën edhe për shtetet që janë në procesin e para-anëtarësimit, ku kushti i përfitimit është ekzistenca e një marrëveshjeje kornizë për përfitimin nga këto programe. Nuk janë të hapura për OJQ-të të gjitha këto programe, meqë disa prej tyre janë të orientuara kryekëput për institucionet përkatëse shtetërore. Një masë e konsiderueshme e këtyre instrumenteve të ofruara për shtetet që janë në proces të para-anëtarësimit përfshijnë komponentin e bashkëfinancimit, ku programi i BE-së mbulon pjesën kryesore të buxhetit, porse një pjesë duhet të mbulohet nga përfituesi përfundimtar i grantit.

Meqë BE-ja e trajton shoqërinë civile si partner serioz dhe të besueshëm, disa programe specifike janë të orientuara në mënyrë të veçantë për ato, ku synohet rritja e kapaciteteve të tyre për dhënien e kontributit në procese të ndryshme lidhur me

demokratizimin, për çështjet e të drejtave të njeriut, lirës së asociimit, të mediave dhe të ngjashme. Meqë financimi i ofruar nga këto programe nuk mbulon gjithë vlerën e projektit që financohet, nga OJQ-të kërkohet që një përqindje të caktuar (zakonisht nga 5% deri në 20 %) të bashkëfinancohet nga ato. Në këto programe, OJQ-të mund të marrin pjesë duke aplikuar drejtpërdrejt për të qenë përfitues direkt, apo duke qenë partnerë zbatues apo bashkëpunëtorë të një OJQ-je tjetër aplikuese. Zakonisht, këto programe kërkojnë që OJQ-të të kenë subjektivitet juridik, pra, të jenë të regjistruara, të kenë burime të mjaftueshme financiare dhe kapacitetet e nevojshme humane/profesionale për zbatimin e aktiviteteve të propozuara.

Çështja e sigurimit të bashkëfinancimit paraqitet si sfidë për OJQ-të jo vetëm në Republikën e Kosovës, por edhe për shtetet e rajonit që janë në procesin e para-anëtarësimit në BE. Me qëllim të adresimit të kësaj çështjeje dhe ofrimit të mbështetjes së OJQ-ve që të qasen në lehtë në fondet e BE-së, shtetet e rajonit kanë paraparë rregullime të ndryshme ligjore.

2.1 SHQIPËRIA

Republika e Shqipërisë, si një vend kandidat për anëtarësim në BE, nuk ka të aprovuar ndonjë akt të veçantë ligjor apo nënligjor që rregullon çështjen e bashkëfinancimit të OJQ-ve të cilat përfitojnë nga fondet e BE-së. Në anën tjetër, Shqipëria ka ndjekur një model të krijimit të një agjencie qendrore për çështjet të OJQ-ve, nëpërmjet *Ligjit Nr. 10 093 për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile* (Ligji për AMShC). Ky Ligj rregullon organizimin, strukturën dhe funksionimin e kësaj agjencie, me mision të mbështetjes së zhvillimit të sektorit të shoqërisë civile në Shqipëri, nëpërmjet ofrimit të granteve. AMShC ka përgjegjësi për menaxhimin e fondeve publike të destinuara për shoqërinë civile në Shqipëri, të hapë thirrje publike të financimit të OJQ-ve, të bëjë përzgjedhjen dhe të bëjë monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të financimit të ofruar. Nga konteksti i bashkëfinancimit, ky institucion nuk ka ndonjë përgjegjësi të veçantë apo nuk është përcaktuar ndonjë lloj procedure të veçantë për këtë lloj të financimit. Përgjatë kësaj, AMShC ka përgjegjësi të ofrojë mbështetje administrative dhe këshillime për OJQ-të që aplikojnë në fondet e tjera, përfshirë edhe ato të BE-së. Në praktikë, AMShC siguron udhëzime, modele kontratash, procedura raportimi dhe mbikëqyrje për fonde ku ka bashkëfinancim nga burime publike dhe fondet e BE-së, ku paraqitet si institucion lehtësues. Kështu, AMShC shndërrohet në një institucion

të rëndësishëm mbështetës për sigurimin e fondeve të BE-së.

Krahas rolit qendror të AMShC-së në menaxhimin dhe distribuimin e fondeve publike të OJQ-ve në Shqipëri, në njërin anë, dhe përpjekjes së institucioneve për centralizimin e këtij procesi përmes kësaj Agjencie, në anën tjetër, kjo nuk i kufizon institucionet e tjera në Republikën e Shqipërisë që të ofrojnë mbështetje për mbulimin e pjesës së bashkëfinancimit dhe posaçërisht kur bëhet fjalë për nivelin lokal në këtë vend, ku bashkitë (komunat) mund të mbulojnë pjesën e bashkëfinancimit të OJQ-ve në forma të ndryshme. Kjo, meqenëse niveli i decentralizimit në Shqipëri lejon një kompetencë të tillë për bashkitë, si dhe një pjesë e konsiderueshme e projekteve të BE-së mund të kërkojnë bashkëfinancim edhe nga partnerët lokalë. Kështu, një bashkëpunim në mes bashkive dhe AMShC-së rrit mundësinë për të marrë fonde nga BE-ja. Përveç kësaj, disa shembuj të analizuar tregojnë ofrimin e bashkëfinancimit të OJQ-ve partnere në zbatimin e programeve të BE-së, për të mbuluar pjesë të bashkëfinancimit, si nga niveli ministror ashtu edhe nga niveli i bashkive, e sidomos tek projektet e bashkëpunimit ndërkomunal.

2.2 MALI I ZI

Republika e Malit të Zi ka krijuar një model të veçantë lidhur me bashkëfinancimin e projekteve të OJQ-ve që përfitojnë nga fondet e BE-së nëpërmjet dy mekanizmave kryesorë: sigurimi i ndarjes buxhetore për bashkëfinancimin e projekteve të OJQ-ve dhe rregullimi i procedurave nëpërmjet një akti nënligjor të Qeverisë së Malit të Zi. Kështu, ndryshimi i *Ligjit për Organizatat Joqeveritare në Malin e Zi në vitin 2017 (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi Nr. 37/14)*, nga aspekti ligjor ka siguruar një përqindje të caktuar (jo më pak se 0.5%), si kriter minimal, për financimin e projekteve dhe programeve të OJQ-ve në Malin e Zi, si në vijim:

- 0.3 % e shumës së përgjithshme të ndarjes vjetore buxhetore të Malit të Zi ndahen për financimin e projekteve dhe programeve të OJQ-ve në fushat me interes publik (një spektër i gjërave të përcaktuara me këtë ligj dhe me ndonjë ligj tjetër);
- 0.1 % e shumës së përgjithshme të ndarjes vjetore buxhetore të Malit të Zi ndahen për financimin e projekteve dhe programeve të OJQ-ve në fushën e mbrojtjes së personave me aftësi të kufizuar; dhe
- 0.1 % e shumës së përgjithshme të ndarjes vjetore buxhetore të Malit të Zi ndahen për financimin e projekteve dhe programeve të OJQ-ve që përfitojnë nga fondet e BE-së, me qëllim të sigurimit

të plotë apo të pjesshëm të mjeteve të bashkëfinancimit.

Sipas këtij modeli, Qeveria e Malit të Zi obligohet që çdo vit të ndajë një vlerë prej 0.1% të ndarjes së përgjithshme buxhetore, për mbështetjen e OJQ-ve në emër të bashkëfinancimit. Ky ligj po ashtu ka përcaktuar se procedurat dhe kriteret e tjera lidhur me zbatimin e këtij neni përcaktohen me akt nënligjor. Kështu, e gjitha procedura dhe kriteret e tjera janë rregulluar sipas *Rregullores Nr. 1198 për procedurën dhe mënyrën e bashkëfinancimit të projekteve dhe programeve të organizatave joqeveritare të mbështetura nga fondet e Bashkimit Evropian*, e miratuar me 13 shtator 2018 nga Qeveria e Malit të Zi. Sipas kësaj Rregulloreje, financimi ofrohet për projektet e realizuara nga OJQ-të e regjistruara dhe që operojnë në këtë shtet, qoftë si zbatues apo partner i programit, dhe që zbatohen tërësisht apo pjesërisht në Malin e Zi. Çdo financim i tillë është subjekt i shpalljes publike dhe mbulimi i pjesës së bashkëfinancimit të projekteve mund të jetë deri në 100 % të pjesës obligimit për OJQ-të.

Si pjesë e materialeve për aplikim, sipas kësaj Rregulloreje, OJQ-të duhet të bashkëngjisin marrëveshjen për përfitim nga fondet apo programi i caktuar i BE-së, përfshirë këtu buxhetin e projektit dhe deklaratën e bashkëfinancimit nga burimet e tjera, nëse është e aplikueshme. Në rast të përfitimit,

OJQ-të kanë obligime për raportim periodik dhe raportin përfundimtar, që është subjekt i kontrollit dhe masave administrative, nëse ka mospërmbushje të kontratës së bashkëfinancimit, që konsiston në kthimin e mjeteve, bashkë me kamatëvonesën. Institucioni zbatues i këtij akti nënligjor në Malin e Zi është Ministria e Administratës Publike, ministri e cila në muajin mars të çdo

viti publikon shpalljen për bashkëfinancimin e projekteve dhe programeve të OJQ-ve të mbështetur nga fondet e BE-së. Pas përfundimit të procedurave të shpalljes, përfituesit mund të kërkojnë disbursimin e fondeve jo më larg se data 1 dhjetor e vitit fiskal.

2.3 KROACIA

Duke qenë Kroacia shtet anëtar i BE-së, OJQ-të në këtë vend kanë më shumë qasje në fondet e BE-së dhe këto shfrytëzohen jashtëzakonisht shumë nga OJQ-të. Lidhur me këtë, Republika e Kroacisë ka siguruar infrastrukturë ligjore si dhe mekanizma për zbatimin e mbulimit të pjesës së financimit të OJQ-të që përfitojnë nga fondet e BE-së, qoftë në nivelin qendror apo edhe në nivelin lokal. Kështu, në qendër të mbështetjes së sektorit publik për OJQ-të në Kroaci, në drejtim për forcimin e kapaciteteve të OJQ-ve me qëllim të zbatimit efektiv të projekteve të BE-së, qëndron Zyra për Bashkëpunim me OJQ-të (GOfNGOs), e themeluar në vitin 1998. Kjo zyrë ka ndryshuar mandatin e saj në vitin 2012, dhe sipas rregullores përkatëse ku përcaktohen kompetencat dhe veprimtaria e saj (*Uredbu o Uredu za Udruge*), ajo ka për qëllim zhvillimin e bashkëpunimit me shoqatat dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile, dhe kryen detyra profesionale, analitike, këshilluese dhe administrative, përfshirë zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe pjesëmarrjen në programet e BE-së për shoqërinë civile, si dhe bashkëfinancimin e projekteve të shoqatave që marrin mbështetje nga BE-ja. Pra, kjo njësi mbulon komponentin e këshillimit për pjesëmarrje në programet e BE-së dhe komponentin e bashkëfinancimit.

Me qëllim të zbatimit të mandatit të saj, kjo zyrë miraton në baza vjetore një Udhëzues për përcaktimin e rregullave, kriterëve dhe

procedurave të bashkëfinancimit të OJQ-ve që përfitojnë nga fondet e BE-së (*Pravila za sufinanciranje projekata organizacije dristva ogovorenih u okviru programa Evropske Unije i inozemnih fondova za 2025. godinu*). Sipas kësaj rregullative, kjo zyrë në baza vjetore hap shpallje publike për bashkëfinancimin e OJQ-ve që përfitojnë nga fondet e BE-së për të mbuluar pjesë e domosdoshme të projekteve. Synimi i zyrës është gjithnjë siguri i gjithë përfshirjes së OJQ-ve në këtë proces. Ky udhëzues që nxirret çdo vjet përcakton rregullat si në vijim:

- Programet e BE-së dhe përqindjen e mbulimit të vlerës së bashkëfinancimit për OJQ-të që përfitojnë nga këto programe;
- Në këtë lloj financimi mund të aplikojnë OJQ-të dhe organizatat e ngjashme jofitimprurëse që veprojnë në Republikën e Kroacisë dhe që projekti i tyre zbatohet pjesërisht apo tërësisht në këtë shtet.
- Mund të përfitojnë vetëm OJQ-të që kanë kontratë të nënshkruar apo rezultat të shpallur zyrtarisht për përfitim nga fondet e BE-së;
- Kufizimin që një OJQ mund të përfitojë tri (3) herë nga ky lloj financimi. Përgjithësisht, në rast të fondeve shtesë mund të ketë financime shtesë;
- Evitimin e financimit të dyfishtë; dhe
- Çështjet e tjera procedurale lidhur me aplikimin dhe vlerësimin e aplikacioneve.

Vendimmarrja në lidhje me aplikacionet është periodike dhe kjo varet nga disponueshmëria e fondeve. Pas përfundimit të procedurës, përfituesit nënshkruajnë marrëveshje me këtë zyrë për obligimet e dyanshme lidhur me bashkëfinancimin.

Nga perspektiva e sigurimit të financimit, Republika e Kroacisë siguron mbështetje financiare për bashkëfinancimin e OJQ-ve nëpërmjet ndarjeve buxhetore, ku si komponentë e rëndësishme paraqiten taksat që arkëtohen nga ushtrimi i veprimtarisë së lojërave të fatit. Edhe në këtë fushë Kroacia ka një rregullim vjetor, për përcaktimin e përqindjes së destinimit të të hyrave nga ky sektor. Kështu, sipas Rregullores për kriteret e përcaktimit të përfituesve dhe mënyrën e shpërndarjes së pjesës së të ardhurave nga lojërat e fatit për vitin 2025 (*Uredbu o Kriterijima za Utvrdivanje Korisnika i Nacinu*

Raspodjele Dijela Prihoda id Igara na Srecu za 2025. Godinu) kap një vlerë prej 3,44% të të hyrave që të arkëtohen për kontribut në luftën kundër abuzimit me droga dhe të gjitha format e tjera të varësisë. Sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, 13,85% e vlerës së inkasuar orientohet në programin për bashkëfinancimin e projekteve të BE-së për organizatat e shoqërisë civile.

Meqë Kroacia ka një element të theksuar të decentralizimit, njësitë e vetëqeverisjes lokale mund përfshijnë në buxhetet tyre fonde të bashkëfinancimit dhe të ofrojnë një financim të tillë. Po ashtu, një pjesë e tyre kanë edhe rregullim të veçantë që adresojnë financimin e projekteve të OJQ-ve, përfshirë edhe çështjen e bashkëfinancimit (Pravilnik i Financiranju Projekata i Programa Udruga Napodrucj u Grad Abelišca).

2.4 MAQEDONI E VERIUT

Ngjashëm me Republikën e Kosovës, Republika e Maqedonisë së Veriut nuk ka një infrastrukturë të veçantë ligjore për sigurimin e bashkëfinancimit të projekteve të OJQ-ve që përfitojnë nga fondet BE-së, ashtu siç as legjislacioni që rregullon themelimin dhe funksionimin e OJQ-ve nuk përmban dispozita që adresojnë këtë çështje. Po ashtu, Maqedonia e Veriut ende nuk ka një normë të përcaktuar ligjërish dhe as një portal të centralizuar që të menaxhojë bashkëfinancimet e OJQ-ve që përfitojnë nga programet e BE-së.

Megjithatë, në dokumentet strategjike shtetërore, Maqedonia e Veriut ka ndërmarrë përpjekje për të krijuar një sistem më të decentralizuar dhe fleksibil të bashkëfinancimit. Sipas *Strategjisë së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Shoqërisë Civile 2022–2024*, në kuadër të qëndrueshmërisë financiare të OJQ-ve janë paraparë dy masa thelbësore për sigurimin e bashkëfinancimit: (1) miratimi i një vendimi qeveritar që obligon të gjitha trupat administrative të mbështesin OJQ-të në kontekstin e projekteve të BE-së, dhe (2) themelimi i një fondi buxhetor për bashkëfinancim, i cili do të jetë i qasshëm në çdo kohë për OJQ-të që kërkojnë mbulimin e pjesës së pambuluar të projekteve.

Një qasje e ngjashme pasqyrohet edhe në *Strategjinë për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Shoqërisë Civile 2025–2028*, ku

bashkëfinancimi trajtohet si një nga prioritetet kryesore për forcimin e mekanizmave të qëndrueshmërisë financiare të sektorit civil. Ky dokument nënvizon nevojën për krijimin e një fondi shtetëror për mbështetjen e OJQ-ve në projektet e BE-së, përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për sigurimin e fondeve të nevojshme, si dhe krijimin e një linje buxhetore të dedikuar për bashkëfinancim në nivel qendror.

Në planin e veprimit të kësaj strategjie parashihen masa konkrete, përfshirë krijimin e një mekanizmi transparent për bashkëfinancimin e projekteve, mbulimin e pjesës së bashkëfinancimit përmes buxhetit shtetëror ose bashkëpunimit ndërmisor, forcimin e mandatit të Zyrës për Bashkëpunim me OJQ-të për koordinim më të mirë të procesit, si dhe ofrimin e trajnimeve dhe udhëzimeve për institucionet publike që menaxhojnë fondet e bashkëfinancimit.

Po ashtu, Raporti i Progresit të Bashkimit Evropian për vitin 2025 për Maqedoninë e Veriut thekson nevojën për krijimin e një “Fondi Garancie” për bashkëfinancimin e projekteve të BE-së deri në vitin 2026. Ky mekanizëm shihet si një hap i rëndësishëm drejt rritjes së qëndrueshmërisë financiare të sektorit civil dhe përmirësimit të qasjes së OJQ-ve në fondet evropiane, duke forcuar rolin e tyre në proceset e integritetit evropian të vendit.

3. DISA OPSIONE PËR POLITIKËBËRËSIN

Nevoja për adresimin e çështjes së bashkëfinancimit në Republikën e Kosovës është ngritur nga shoqëria civile dhe ka qenë e trajtuar nëpërmjet *Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019 – 2023*. Kjo strategji, në kuadër të objektivit të saj të dytë (Përmirësimi i kornizës institucionale dhe ligjore për financim në zhvillimin e qëndrueshëm të programeve dhe projekteve të organizatave të shoqërisë civile me interes publik), ka paraparë dy veprime kryesore për sigurimin e këtij mekanizmi:

- krijimi i një sistemi për bashkëfinancim të projekteve të OJQ-ve të financuara nga BE-ja/ miratimin e një akti që rregullon standardet dhe procedurat e bashkëfinancimit të projekteve të OJQ-të të financuara nga BE-ja; dhe
- krijimi i një fondi (ndarje buxhetore) për bashkëfinancim, i vendosur dhe i menaxhuar nga institucioni përkatës.

Edhe pse synim ka qenë që deri në vitin 2023 të përfundojnë këto aktivitete, institucionet përgjegjëse nuk kanë ndërmarrë hapat e nevojshëm për realizimin e këtyre aktiviteteve.

Kështu, raporti i vlerësimit të Strategjisë ka konstatuar se nuk pasur asnjë rezultat në këtë drejtim, për shkak të mungesës së vullnetit institucional për zhvillimin e një sistemi të tillë. Sipas këtij raporti, ky sistem i bashkëfinancimit do të mund të realizohej nëpërmjet plotësimit dhe ndryshimit të Rregullores për Financimin Publik të OJQ-ve.

Si rrjedhojë, përveç iniciativës për adresimin e çështjes së bashkëfinancimit në Kosovë, nuk është zhvilluar ndonjë analizë e detajuar se cilat mund të jenë opsionet që mund krijojnë infrastrukturën ligjore për sigurimin e mekanizmit të bashkëfinancimit të projekteve të OJQ-ve që përfitojnë nga projektet e BE-së. Në vijim janë paraqitur disa opsione për këtë, që mund të ndihmojnë institucionet publike për adresimin e shpejtë të këtij boshllëku që ndikon në qasjen e OJQ-ve kosovare në fondet e BE-së.

3.1 OPSION I STATUS QUO-S

Sipas analizave të bëra, nuk është rregulluar fusha e ofrimit të mbështetjes për bashkëfinancimin e projekteve apo programeve të OJQ-ve në Kosovë që përfitojnë nga fondet e BE-së. Pra, nuk as ndonjë rregullim specifik për këtë formë të financimit të OJQ-ve, por nuk ka as ndonjë ndalesë ligjore për realizimin e kësaj. Kësisoj, nuk ka asnjë ndalesë për Zyrën e Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ndonjë ministri apo për ndonjë komunë që ofrojë këtë lloj bashkëfinancimi për OJQ-të. Andaj, në mungesë të ndonjë akti normativ që rregullon këtë fushë apo të procedurave përkatëse, institucionet publike në Kosovë mund të realizojnë këtë lloj financimi, me kusht që të respektohen kriteret dhe procedurat e përcaktuara në Rregulloren për Financimin Publik të OJQ-ve. Natyrisht, paraprakisht duhet të kenë ndarje buxhetore në kategorinë e shpenzimeve “subvencione dhe transfere” për këtë qëllim.

Zbatimi i ndonjë programi të bashkëfinancimit sipas këtij opsioni nga institucionet publike duhet të ketë parasysh disa çështje praktike përgjatë zbatimit të Rregullores për Financimin Publik të OJQ-ve, si në vijim:

- Interesi publik lidhur me programin apo projektin duhet të argumentohet nga prizmi që integrimi evropian paraqet një synim kombëtar për Republikën e Kosovës, përkatësisht institucionin, andaj kjo është vlerë kushtetuese dhe zbatimi i tyre sjell vlerë të dukshme në shoqëri,

meqë adreson një komponentë të integritit evropian;

- Në kuadër të përgjegjësisë së institucioneve publike për të hartuar një plan vjetor të mbështetjes financiare, ky lloj i mbështetjes mund të reflektohet si një seksion i veçantë apo pjesë e planit me shënime të veçanta, që ky financim synon mbulimin e pjesës së bashkëfinancimit të OJQ-ve që përfitojnë nga fondet e BE-së;
- Në lidhje me nenin 10, paragrafi 1.4, i Rregullores për Financimin Publik të OJQ-ve, ku kërkohet që OJQ-ja të mos ketë pranuar burime të tjera të financimit për të njëjtat aktivitete, duhet të specifikohet shumë qartë se financimi i BE-së në këtë rast nuk merret parasysh meqë nuk mbulon pjesën e mbetur të bashkëfinancimit, dhe kjo është e vlefshme vetëm për ndonjë financim nga ndonjë institucion tjetër, vendor apo ndërkombëtar;
- Në lidhje me neni 11, paragrafi 1.2, i Rregullores për Financimin Publik të OJQ-ve, ku trajtohet formati për propozimbuxhetin e projektit, institucioni zbatues duhet të specifikojë qartë në format çështjen e bashkëfinancimin dhe të jetë i përshtatshëm për këtë;
- Në lidhje me nenin 14 të Rregullores për Financimin Publik të OJQ-ve ku rregullohet përmbajtja e udhëzimeve për aplikuesit, në të gjitha pikat e

përcaktuara duhet të trajtohet dhe të sqarohet ndërlidhja e shpalljes me çështjen e bashkëfinancimit dhe udhëzimet të jenë të përshtatshme për qëllimin e synuar, pra, mbulimin e pjesës së pa mbuluar të OJQ-ve që përfitojnë nga fondet e BE-së; dhe

- Përgjatë gjithë procedurës administrative lidhur me trajtimin e aplikacionit, e sidomos përgjatë vlerësimit përmbajtjesor të tyre, vlerësuesi gjithnjë duhet të ketë parasysh edhe perspektivën e bashkëfinancimit, konkretisht programin e BE-së nga i cili OJQ-ja përfiton fonde.

Pra, Rregullorja për Financimin Publik të OJQ-ve në aspektin përmbajtjesor nuk ka ndonjë kufizim lidhur me sigurimin bashkëfinancimit për OJQ-të, por në aspektin procedural zbatimi duhet të bëhet në përshtatje me qëllimin për ofrimin e bashkëfinancimit. Lidhur me këtë, një qarkore e lëshuar nga organi propozues i këtij akti nënligjor (Zyra e Kryeministrit/ Zyra për Qeverisjen e Mirë apo Ministria përkatëse për financa), mund t'i ndihmojë institucioneve zbatimin më të lehtë të kësaj procedure.

Në anën tjetër, Rregullorja për Financimin Publik të OJQ-ve ka një mekanizëm tjetër “simbolik” për sigurimin e bashkëfinancimit për OJQ-të që përfitojnë nga fondet e BE-së. Sipas nenit 2, paragrafi 5 i këtij akti nënligjor, financimi publik që realizohet si një pagesë e njëhershme deri në pesëqind (500 €) euro nuk i nënshtrohet procedurave dhe mund të jepet edhe si pagesë direkte. Edhe pse ky mekanizëm nuk është shumë domethënës për rastet kur shuma e bashkëfinancimit për një OJQ është e lartë, në rastet e shumave të vogla mund të jetë si alternativë, sidomos nëse mund të sigurohen nga dy apo më shumë institucione.

Ky opsion i paraqitur nuk është ideal, meqë vetë zbatimi i Rregullores për Financimin Publik të OJQ-ve në shumë raste është paraqitur si sfidë për institucionet, pasi kërkon që institucioni të ketë kapacitetet të nevojshme administrative për zbatimin e tij (kapacitetet për hartimin e planit të mbështetjes, për hartimin e thirrjeve, për pjesëmarrjen në Komisionin Vlerësues, Komisionin e Ankesave dhe për mbikëqyrjen e zbatimit). Sfidat kanë qenë të theksuara edhe në nivelin komunal. Për më tepër, zbatimi i këtij akti nënligjor me qëllim të bashkëfinancimit mund të sjellë sfida shtesë për institucionet.

3.2 OPSIONI I LIGJIT VJETOR PËR NDARJET BUXHETORE

Edhe pse Kushtetuta e Republikës së Kosovës, instrumentit të ndarjes buxhetore i referohet vetëm si buxhet, praktika e zbatimit nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës e ka trajtuar këtë si një Projektligj/Ligj. Kjo qasje ka pasur një qëllim praktik, ku përveç përcaktimit të shifrave të ndarjes buxhetore për institucionet, ky dokument ka përmbajtur edhe elemente normative, për të rregulluar boshllëqe të ndryshme lidhur me menaxhimin e financave publike, apo me çështje të tjera të ndërlidhura të natyrave të ndryshme. Së fundmi, ngjashëm me rregullimet e viteve paraprake, *Ligji Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025*, në nenin 11, ka rregulluar disa situata më specifike buxhetore. Kështu, në këtë pjesë janë përcaktuar mjete dhe mënyra e ndarjes së mjeteve për Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, për përkrahjen e Luginës së Preshevës dhe Sanxhakut, për promovimin e vendit dhe për Zyrën e Komuniteteve; janë ndarë mjete nga Ministria e Ekonomisë për financimin e projekteve kapitale për ndërmarrjet publike, si dhe për Kuvendin e Republikës së Kosovës për financimin e RTK-

së. Për më tepër, në paragrafin 12 të këtij neni është e normuar një formë e bashkëfinancimit për zbatimin e marrëveshjeve me trupat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, që synojnë realizimin e projekteve apo programeve.

Kjo praktikë e rregullimeve të përkohshme nëpërmjet Ligjit Vjetor për Ndarjet Buxhetore është zbatuar mbi një dekadë dhe ka krijuar zgjidhje për situatat ku kërkohet adresim i shpejtë, edhe pse nga këndvështrimi i rregullimit ligjor nuk është një formë shumë e preferuar. Sidoqoftë, në përputhje me këto praktika, një dispozitë e tillë lidhur me bashkëfinancimin do të krijonte një zgjidhje të përkohshme, deri në rregullimin më të mirë dhe më permanent të kësaj çështjeje. Kjo dispozitë do siguronte ndarjen buxhetore me qëllim të bashkëfinancimit të OJQ-ve që përfitojnë nga fondet e BE-së, do të përcaktonte institucionin përkatës që zbaton këtë përgjegjësi dhe do të autorizonte një institucion që të përcaktonte rregullat dhe procedurat e tjera. Një dispozitë e tillë do të ishte si në vijim:

Neni 11

Ndarjet buxhetore të tjera

.....

13. Mjetet e ndara në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës në vlerë prej 000.000 € në nënprogramin “Bashkëfinancimi i OJQ-ve”, me kod 0000, në kategorinë e shpenzimeve subvencione dhe transfere, shërbejnë për mbulimin e plotë apo të pjesshëm të përqindjes së bashkëfinancimit të OJQ-ve që kanë përfituar nga fondet e BE-së. Financimi nga ky burim bëhet nëpërmjet shpalljes publike dhe kriterëve të tjera të përcaktuara me vendim të veçantë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe nuk janë në fushëveprimin e Rregullores Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

3.3 OPSIONI I NJË AKTI NËNLIGJOR TË VEÇANTË

LMFPP në nenin 53, paragrafi 3, i përcakton një kompetencë të përgjithshme Ministrit përkatës për financa për rregullimin e kritereve dhe

procedurave për shpenzimin e parasë publike nga kategoria e shpenzimeve “subvencione dhe transfere”, si në vijim:

53.3 Ministri është shprehimisht i autorizuar që të nxjerrë rregullat të cilat duhet të respektohen nga organizatat buxhetore ose autoritetet publike gjatë përzgjedhjes së pranuesit ose pranuesve si dhe përcaktimit të shumës ose shumave të cilat do të jepen në formë të grantit, donacionit ose subvencionit. Këto rregulla duhet të sigurojnë që procesi të ketë për qëllim arritjen e synimeve të Kuvendit kur i njëjti e ka autorizuar grantin, donacionin ose subvencionin përkatës në ligjin përkatës për ndarjet buxhetore.

Mbështetur në këtë dispozitë ligjore, Ministria përkatëse për financa ka nxjerrë Rregulloren për Financimin Publik të OJQ-ve, dhe ka përcaktuar një sistem të financimit publik të OJQ-ve me rregulla dhe procedura uniforme për të gjitha institucionet, përkatësisht organizatat buxhetore. Po ashtu, kjo ministri ka pasur përpjekje të nxjerrë një akt nënligjor tjetër që rregullon në mënyrë të ngjashme edhe financimin e personave fizikë dhe juridikë, që nuk janë OJQ, për të pasur uniformitet, transparencë dhe llogaridhënie më të madhe në këto procese akoma të papërfunduara. Për më tepër, referuar në nenin 53, paragrafi 3, të LMFPP-së, një sërë institucionesh të tjera kanë nxjerrë rregulla për caktimin e kritereve dhe procedurave të ndryshme të financimit publik në sfera të ndryshme. Si rrjedhojë, kjo bazë ligjore mund të shërbejë edhe për nxjerrjen e një akti nënligjor që rregullon kriteret dhe procedurat

e bashkëfinancimit të projekteve të OJQ-ve që janë përfitues nga fondet e BE-së.

Hartimi i këtij akti nënligjor do të mund të ndjektë përvojën e hartimit të Rregullores për Financim Publik të OJQ-ve, ku institucioni përkatës dhe shoqëria civile paraprakisht zhvillojnë punimet analitike lidhur me specifikat e këtij modeli, më pas themelohet një grup punues në përbërje mikse. Pjesëmarrja e shoqërisë civile në këtë proces do të siguronte përfaqësimin e këtij sektori në fazat e hershme, ku të gjitha çështjet e sipërshënuara do të diskutoheshin dhe vendoseshin marrë parasysh edhe qëndrimin e OJQ-ve. Në fazat e më tutjeshme, organizimi i mirëfilltë i procesit të konsultimeve publike do të kishte vlerës të shtuar për ngritjen e cilësisë së procesit, respektivisht hartimin dhe miratimin e një akti nënligjor që do të ofronte një rregull të mirë për çështjen e bashkëfinancimit së paku për një dekadë.

Një akt nënligjor i tillë duhet të përmbajë këto elemente, për të adresuar çështjen e bashkëfinancimit për projektet e OJQ-ve:

- Akti nënligjor duhet të ketë fushëveprim vetëm për çështjen e financimit të projekteve dhe programeve të OJQ-ve që janë përfitues prej fondeve të BE-së;
- Akti nënligjor duhet të rregullojë financimin e ofruar nga organizatat buxhetore apo një organizatë buxhetore, i cili mund të jetë modele dhe për organizatat publike që nuk janë organizata buxhetore;
- Akti nënligjor duhet të adresojë nëse disa organizata buxhetore mund të realizojnë një financim të tillë apo do të adaptojnë një sistem të centralizuar, ku vetëm një institucion ofron një financim të tillë;
- Akti nënligjor duhet të normojë disa parime bazë të këtij lloji financimi publik siç janë transparenca, mosdiskriminimi, konkurrueshmëria, interesi publik, llogaridhënia, eliminimi i konfliktit të interesit dhe të ngjashme;

- Akti nënligjor duhet të përcaktojë kriteret minimale se si një OJQ mund të jetë përfitues nga një financim i tillë;
- Akti nënligjor duhet të përcaktojë qartë procedurat e aplikimit, të vlerësimit të aplikacioneve, ankesave, lidhjes së marrëveshjes, monitorimit dhe mbikëqyrjes së marrëveshjeve dhe masave administrative për shkelësit e marrëveshjeve; dhe
- Akti nënligjor duhet të adresojë edhe çështjet të tjera të përgjithshme lidhur me procesin e bashkëfinancimit.

Një akt nënligjor i tillë do të siguronte infrastrukturën e nevojshme ligjore për ofrimin e mbështetjes financiare për OJQ-të që përfitojnë nga fondet e BE-së, në mënyrë unike dhe afatgjate. Me qëllim të ndërtimit të ekspertizës së nevojshme, rekomandohet që përcaktimi të jetë vetëm për një institucion zbatues për të cilin sigurohet ndarja buxhetore dhe nga i cili realizohet i gjithë procesi i bashkëfinancimit të projekteve të OJQ-ve që përfitojnë nga fondet e BE-së.

3.4 OPSIONI I NDRYSHIMEVE LIGJORE

Opsioni i hartimit të një akti nënligjor nuk do të mund të siguronte çdo herë buxhetin e nevojshëm për ofrimin e mbështetjes financiare për OJQ-të që përfitojnë nga fondet e BE-së, dhe kjo do të ishte subjekt i Ligjit Vjetor për Ndarje Buxhetore. Andaj, marrë parasysh modelet e shqyrtuara në këtë analizë, përcaktimi i një përqindjeje të caktuar për çështjen e bashkëfinancimit apo krijimi i një mekanizmi të veçanta për çështjet e OJQ-ve, do të kërkonte ndryshime ligjore. Sipas perspektivës së legjislacionit të Republikës së

Kosovës, përcaktimi i një përqindjeje të caktuar për ofrimin mbështetjes financiare për OJQ-të që përfitojnë nga fondet e BE-së apo edhe për fushat tjera që kanë të bëjnë me OJQ-të, duhet të adresohet nëpërmjet ndryshimeve në LMFPP. Ndërsa, krijimi i ndonjë mekanizmi shtesë në administratë për ofrimin e asistencës për OJQ-të për aplikim në programet e BE-së apo edhe distribuimi i financimit të tillë publik, duhet të adresohet nëpërmjet ndryshimeve të Ligjit për Lirinë e Asociimit.

3.5 KRAHASIMI I OPSIONEVE

Analiza paraqet katër opsione për të adresuar këtë mungesë: Status quo, rregullimi i përkohshëm përmes Ligjit Vjetor për Ndarje Buxhetore, miratimi i një akti nënligjor të

veçantë dhe ndryshimet ligjore. Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura përparësitë dhe mangësitë e opsioneve të shqyrtuara.

Opsioni	Përparësitë	Mangësitë
Status Quo	• Mund të zbatohet menjëherë • Nuk kërkon ndryshime ligjore • Fleksibilitet institucional	• Procedura të komplikuar • Kapacitetet administrative të ulëta • Mungesë qartësie dhe uniformiteti
Ligji Vjetor për Ndarjet Buxhetore	• Mundëson zgjidhje të shpejtë • Mund të krijojë dispozitë specifike për bashkëfinancim • Siguron mjetet buxhetore	• Zgjidhje e përkohshme • Varet nga procesi vjetor buxhetor • Nuk krijon sistem afatgjatë
Rregullore e Veçantë (Akti nënligjor)	• Zgjidhje afatgjatë dhe e qëndrueshme • Kornizë e qartë procedurale • Transparencë dhe uniformitet • Mund të zbatohet shpejt pa ndryshime ligjore • Përfshirje e shoqërisë civile në hartim	• Kërkon proces të mirëfilltë hartimi dhe konsultimi • Duhet siguruar ndarje buxhetore çdo vit
Ndryshime Ligjore	• Zgjidhje e fortë dhe e qëndrueshme • Mundëson përqindje të garantuar të fondit • Mund të krijojë mekanizma të rinj institucionale	• Proces i gjatë dhe politikisht i ndjeshëm • Më i vështirë për t'u miratuar • Kosto më të larta administrative

Nga këto opsione, opsioni i miratimit të një akti nënligjor të veçantë (Rregullore për Bashkëfinancimin e OJQ-ve për projektet e BE-së) del të jetë qasja më e qëndrueshme, më efikase dhe më e lehtë për t'u zbatuar. Ky opsion siguron:

- kornizë të qartë procedurale;
- parime uniforme për të gjitha institucionet;
- transparencë dhe llogaridhënie;
- një model afatgjatë që mund të rregullojë procesin për të paktën një dekadë; dhe
- thjeshtim të procesit të bashkëfinancimit për OJQ-të pa nevojë për ndryshime ligjore të ndërlikuara.

Rregullorja do të mund të ndërtohej duke ndjekur modelin e Rregullores ekzistuese për Financimin Publik të OJQ-ve, përfshirë konsultimet e thelluara me shoqërinë civile dhe institucionet relevante. Ajo do të vendoste qartë kompetencat, procedurat, kriteret, monitorimin dhe masat administrative. Në këtë mënyrë, opsioni i rregullores paraqet mënyrën më të balancuar, të shpejtë dhe të zbatueshme për të mbyllur boshllëkun e tanishëm ligjor dhe për të fuqizuar qasjen e OJQ-ve kosovare në fondet e BE-së.

4. SIGURIMI I BASHKËFINANCIMIT NGA NIVELI KOMUNAL

Në opsionin e dhënë të *status quo*-s apo në çfarëdo opsion tjetër që financimin për OJQ-të përfituese nga fondet e BE-së e trajton në mënyrë të decentralizuar, secili institucion mund të ofrojë një mbështetje të tillë, përfshirë edhe komunat. Në kontekstin e komunave, legjislacioni aktual ka krijuar infrastrukturë të mirëfilltë ligjore, e cila rregullon bashkëpunimin e komunave dhe mundëson që këtë lloj të financimit ta realizojnë dy e më shumë komuna në mënyrë të përbashkët, nëpërmjet bashkëpunimit.

Ligji Nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal (Ligji për Bashkëpunim Ndërkomunal) rregullon bashkëpunimin ndërkomunal ndërmjet komunave të Republikës së Kosovës mes vete, si dhe ndërmjet komunave të Republikës së Kosovës me institucionet e tjera të vetëqeverisjes lokale jashtë Republikës së Kosovës. Fushat ku mund të krijohet bashkëpunimi janë ato ku komunat gëzojnë kompetenca vetanake dhe të zgjeruara, sipas Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre fushave janë të ndërlidhura ngushtë edhe me aktivitetet e OJQ-ve, siç janë zhvillimi lokal ekonomik, mbrojtja e mjedisit lokal, përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale, promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, shërbimet familjare dhe të tjerat për mirëqenie sociale; turizmi, aktivitetet kulturore dhe të ngjashme.

Komunat në këto fusha ofrojnë financim publik për OJQ-të dhe ato mund të lidhin marrëveshje për ofrimin e një financimi të tillë në mënyrë më të zgjeruar apo edhe të bashkëfinancimit të OJQ-ve lokale që përfitojnë nga fondet e BE-së. Një bashkëpunim i tillë fillon me lidhjen e një marrëveshjeje ndërkomunale, sipas proceduarve të Ligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal, e cila duhet të përmbajë:

- palët kontraktuese;
- lëndën kryesore të marrëveshjes, qëllimin dhe afatin e saj kohor;
- të drejtat dhe detyrimet e secilës palë të përfshirë në marrëveshje;
- formën ligjore të bashkëpunimit dhe burimet e financimit dhe buxhetit;
- kushtet për tërheqje nga marrëveshja dhe shkëputjen e marrëveshjes;
- procedurën e zgjidhjes së konflikteve eventuale;
- hollësitë e tjera të marrëveshjes ashtu siç janë pajtuar palët/komunat partnere.

Ligji për Bashkëpunim Ndërkomunal njeh disa lloje të bashkëpunimit që mund të krijojnë komunat, ku forma më e përshtatshme për realizimin e një marrëveshjeje për një program të bashkëfinancimit të OJQ-ve që përfitojnë nga fondet e BE-së është sipas nenit 15, ku një komunë mund të mandatojë një komunë tjetër që të ushtrojë kompetencat e saj, në emër dhe në llogari të saj. Një marrëveshje e tillë lidhet

nga kryetarët e komunave, pas aprovimeve paraprake të kuvendeve komunale dhe duhet të përcaktojë:

- komunën e cila i kryen punët në kompetencë të komunës ose komunave për të cilat kryhen punët;
- llojin e punëve dhe lartësinë e kompensimit apo taksat e shfrytëzuesit për kryerjen e punëve;
- kohëzgjatjen e kryerjes së punëve;
- kushtet dhe procedurën për pushimin e marrëveshjes, dhe
- çështje të tjera.

Konkretisht, nëpërmjet një marrëveshjeje, disa komuna të një regjioni mund të lidhin një marrëveshje të tillë për të financuar OJQ-të që operojnë në atë regjion, me qëllim të bashkëfinancimit të OJQ-ve që përfitojnë nga fondet e BE-së. Kjo marrëveshje, përveç pikave të sipërshënuara, duhet të specifikojë çështjen e efektit financiar dhe mënyrën e vendimmarrjes, ku komunat tjera mund të përfshihen në procedurat e vlerësimit, duke përcaktuar anëtarët që marrin pjesë në punën e komisioneve përkatëse.

Vlen të theksohet se një bashkëpunim i tillë mund të ushtrohet edhe në mes të një komune në Republikën e Kosovës dhe një komune të një vendi tjetër, por me disa kufizime. Këto marrëveshje duhet të kenë karakter teknik dhe administrativ, dhe komunat nuk kanë të drejtë të heqin dorë nga kompetencat e tyre të përcaktuara me ligj, t'ia delegojnë një komune ose autoriteti publik të huaj ushtrimin e kompetencave të veta si dhe t'ia lejojnë komunës ose autoritetit publik të huaj ushtrimin e çfarëdo pushteti ekzekutiv, administrativ, legjislativ në territorin e Republikës së Kosovës ose që synon të ketë efekt të tillë në territorin e Republikës së Kosovës.

5. PËRFUNDIMI

Analiza ligjore tregon se Republika e Kosovës ka bërë përparime në krijimin e infrastrukturës ligjore për financimin publik të organizatave të shoqërisë civile, por ende mungon një mekanizëm i qartë dhe funksional për bashkëfinancimin e projekteve të mbështetura nga fondet e Bashkimit Evropian. Kuadri ekzistues ligjor, përfshirë Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregulloren për Financimin Publik të OJQ-ve, ofron bazë të përgjithshme, por jo specifike për këtë formë financimi.

Praktikat rajonale tregojnë modele të ndryshme që mund të shërbejnë si shembull. Mali i Zi ka institucionalizuar bashkëfinancimin përmes ndarjeve të detyrueshme buxhetore dhe një rregullore të veçantë qeveritare; Kroacia e ka integruar në sistemin e saj të qëndrueshëm përmes Zyrës për Bashkëpunim me OJQ-të dhe akteve vjetore udhëzuese; ndërsa Maqedonia e Veriut po përpiqet të krijojë një fond të posaçëm për bashkëfinancim si pjesë e strategjisë së saj kombëtare.

Në kontekstin e Kosovës, opsionet e propozuara – që nga përdorimi i kornizës ekzistuese deri te miratimi i një akti të ri nënligjor ose ndryshimet ligjore – paraqesin alternativa realiste për ndërtimin e një mekanizmi të qëndrueshëm. Zbatimi i një ndarjeje buxhetore të dedikuar ose i një akti të posaçëm do të siguronte transparencë, qartësi procedurale dhe përfshirje më të gjerë të OJQ-ve në projektet evropiane, duke përmirësuar ndjeshëm qasjen e tyre në fondet e BE-së dhe duke rritur ndikimin e shoqërisë civile në procesin e integritetit evropian.

